

Ndryshimi i fundit: 04/09/2009 - 09:04

Kerko:

Kerko!

FILLIMI

Kategorite

- ▶ Politike
- ▶ Ekonomi
- ▶ Aktualitet
- ▶ Speciale
- ▶ Rrethe
- ▶ Opinion
- ▶ Shëndetsi
- ▶ Sport
- ▶ Kulture
- ▶ Bota & Rajon
- ▶ Sociale
- ▶ Panorama Supplement

Panorama Newsletter

E-mail Address

- Regjistrohu
- C'regjistrohu

Dergo!

Sherbime

- ▶ Hosroskopi
- ▶ Letra ne Redaksi

Te tjera

- ▶ Spektakel
- ▶ Televizion
- ▶ Auto & Moto
- ▶ Libra

Lojra

- ▶ Smashing
- ▶ Tetris
- ▶ Packman
- ▶ Snake
- ▶ Shah

Moti

- Tirane
- Durres
- Vlore
- Shkoder
- Korce

Chat

- ▶ Albasoul
- ▶ Fajtori
- ▶ Albnetwork

“Paketohe” helmet e Bajzës, nis faza e dytë e projektit

» Vendosur: 27/06/2008 - 09:02

- Nis ambalazhimi i 250 tonë kimikate që ndodhen në stacionin hekurudhor të Bajzës.

SHKODER / RITVAN DIBRA

Pas 16 vitesh pritet më në fund, zhdukja e helmeve nga Malësia e Madhe, ku kanë shkaktuar probleme për shëndetin e banorëve dhe kanë rrezikuar faunën.

Një shumë prej 2.1 milionë dollarë nga PNUD-i dhe qeveria holandeze dhe dy vite punë do të shërbejnë për largimin e 250 tonë kimikatey nga stacioni ndërkombëtar hekurudhor.

Bashkëfinansues në një projekt të tillë do të jetë edhe qeveria shqiptare me një shumë prej 900 mijë dollarësh. Prezenca e këtyre kimikateve pohohet të jetë një nga problemet më të mëdha të kësaj zone, pasi nga ndotja e madhe e ambientit është shënuar jo vetëm një ngordhje masive e peshqve në Liqenin e Shkodrës dhe të pjesës së këtij liqeni që i përket Malësisë së Madhe, por edhe shtimi i pacientëve me sëmundje kancerogjene.

Situata alarmante ka nxitur drejtuesit lokalë, që të kërkojnë heqjen e këtyre lëndëve të rrezikshme për jetën e banorëve.

Projekti është prezantuar pak ditë më parë në qytetin e Shkodrës nga shoqata mjedisore, ku dhe është konkretizuar premtimi për financimin nga ana e qeverisë holandeze. Viti 2010 do të shënojë pastrimin e zonës së Bajzës nga lëndët kimike tepër të rrezikshme. Drejtues të Komunës së Kastratit (ku përfshihet Bajza), pohojnë se rreth 480 tonë kimikate të rrezikshme u sollën në këtë zonë nga Gjermania, nëpërmjet kompanisë "Schmidt-Cretan", në vitin 1992. Sipas specialistëve, sasia e ardhur përmbante lëndë të rrezikshme si: "Toxaphene" dhe "Phenyl Mercury Acetate", të cilat janë ndaluar në vendet e BE-së që nga viti 1983. Që prej asaj kohe, Bajza vazhdon të vuajë pasojat e kësaj ndotjeje. Kryekomunari i Kastratit, Gjovalin Vneshti pohon faktin se, deri para disa kohësh këto lëndë kancerogjene kanë qenë të vendosura në disa magazina të shkatërruara (pa dyer e dritare), thujse në vend të hapur, duke rrezikuar kryesisht fëmijët që shkonin e luanin aty. Pas alarmit të dhënë nga kërret e qeverisjes vendore, u larguan një pjesë e këtyre lëndëve dhe aktualisht në Bajzë ndodhen 250 tonë. Gjithashtu, u morën masa për rregullimin e magazinave, si dhe u vendosën roje pranë këtyre objekteve. Prof.dr. Lirim Selfo, menaxher i projektit për pikat e nxehta mjedisore, thotë se projekti për heqjen e kimikateve të rrezikshme nga Bajza ka filluar në shtator 2007, si dhe do të përfundojë më mars 2010.



Horoskopi 2009

Suplementi STUDENTI



Arkiva e lajmeve

Shtator	2009	>
1	2	3
4	5	6
7	8	9
10	11	12
13	14	15
16	17	18
19	20	21
22	23	24
25	26	27
28	29	30

Lajme te ndryshme

Skadon afati 30 ditor, pese partite s'kthejne lekët ne KQZ

Rehn: Zgjedhjet, më të mira se në '05

Burgu, asnjë leje pas 20 qershorit

Maqo Lakrori: Unë do ta fitoj këtë garë

Rama: Pse bojkotojmë Kuvendin

Sondazhe

A mund te konceptohet nje grua shperfillese ndaj look-ut ?

- Po
- Jo

Voto

Rezultatet



PANORAMA & PANORAMA SPORT



PANORAMA PLUS & UNE GRUAJA



Reklama



UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANES
UET GUIDE 2009 - 2010
(Shkarkoje ketu ne PDF)

